

PËR AUTORIZIMIN E POSEDIMIT TË ARMËVE NË KOSOVË

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në përputhje me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën nr. 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të 10 qershorit 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të datës 25 korrik 1999, të ndryshuar, mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë, Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/8 të datës 20 shtator 1999 për themelimin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/33 të datës 25 maj 2000 për Lejimin e kryerjes së shërbimeve të sigurimit në Kosovë dhe sistemimin e punonjësve të tyre,

Me qëllim të kontrollit të pronësisë, kontrollit, posedimit dhe përdorimit të armëve për të përmirësuar qetësinë, sigurinë dhe rendin publik në Kosovë,

Shpall sa vijon:

Neni 1

PËRKUFIZIMET

Sipas kësaj rregulloreje termet vijuese kanë këto kuptime:

- (a) “armë e autorizuar” do të thotë arma për të cilën është lëshuar leja nga Policia e UNMIK-ut për bartjen e saj;
- (b) “armë e autorizuar nga KFOR-i” do të thotë arma në posedim të një anëtari të TMK-së për të cilën është lëshuar leja e autorizuar nga KFOR-i për mbajtjen e saj;
- (c) “personi i rrezikuar” do të thotë personi i cili është vlerësuar nga Komisioni për vlerësimin e kërcënimeve si person që i është nënshtruar rrezikut apo kërcënimit, prandaj si i tillë i plotëson kushtet për lëshuarjen e lejes së autorizuar për armëmbajtje personalisht nga ai apo për personin i cili është regjistruar në Policinë e UNMIK-ut si truproje e tij;
- (ç) “truproje” nënkuptohet çdo person i pranuar nga Policia e UNMIK-ut për mbrojtjen e personit të rrezikuar;

- (d) “Komisioni për vlerësimin e kërcënimit”, në vijim “KVK”, është komision i themeluar nga Policia e UNMIK-ut për shqyrtimin e kërkesave për lëshuarjen e lejeve të armëmbajtjes dhe për vlerësimin e rrezikut, kërcënimit dhe të sigurisë së personave të rrezikuar;
- (dh) “armë” do të thotë instrument i disenjuar, i përdorur apo i përdorshëm për të shkaktuar dëmtim trupor. Kjo përfëshinë, ndër të tjera, të gjitha llojet e municionit, harqet dhe shigjetat, sprejin, gazin CS, armët me qorrfishekë, armët imituese, armët për alivanosje, taserët (mjetet që punojnë në bazë të elektrohokut) dhe të gjitha llojet e armëve të paraqitura në Aneksin A të kësaj rregulloreje apo armët e ngjashme;
- (e) “leja për armëmbajtje”, në vijim “LA”, do të thotë është një lejekartelë që nuk mund t’i bartet një personi tjetër dhe e obligon për ta mbajtur armën e autorizuar në çdo kohë;
- (ë) “organ kompetent për zbatimin e ligjit” është Policia Civile dhe Misioni i Administratës së Përkohshme i Kombeve të Bashkuara në Kosovë, i njohur si Policia Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara dhe prania e sigurisë ndërkombëtare e njohur si KFOR¹ dhe
- (f) “Trupat Mbrojtëse të Kosovës”, më tej TMK, janë organ i themeluar sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/8.

Neni 2

AUTORIZIMET E POLICISË SË UNMIK-ut

Policia e UNMIK-ut, si organ i vetëm përgjegjës për autorizimin e mbajtjes së armëve në Kosovë, është përgjegjëse për lëshimin e lejeve për armëmbajtje (LA), me përjashtim të armëve të autorizuar nga KFOR-i. Komisari i Policisë së UNMIK-ut nxjerr udhëzime administrative dhe procedura standarde të punës për lëshimin e LA-ve, ku përcaktohen kushtet dhe rrethanat që vlejnë për to, duke përfshirë këtu edhe procedurat dhe kërkesat për përdorimin e tyre.

Neni 3

LËSHIMI I LEJEVE PËR ARMËMBAJTJE

3.1. Një person vetëm ligjërisht mund të pesedojë, kontrollojë apo ta përdorë armën për të cilën i është lëshuar LA-ja.

3.2. LA-ja i lëshohet vetëm personit të rrezikuar për vetëmbrojtje apo truporëve personale të tij a të saj, të regjistruar dhe të aprovuar zyrtarisht vetëm për mbrojtjen e një personi të tillë të rrezikuar apo të kërcënuar nga përdorimi i forcës vdekjeprurëse.

¹ Policia e UNMIK-ut dhe KFOR-i, sipas kësaj rregulloreje, konsultohen dhe koordinojnë punët sipas nevojës lidhur me zbatimin e detyrave dhe përgjegjësi.

3.3. Kërkesa e bërë nga një person për LA e bazuar në faktin se ai apo ajo është person i rrezikuar duhet të mbështetet me dëshmi për rrezikueshmërinë, duke përfshirë ndër të tjerat edhe informatat nga raportet e policisë dhe vlerësimet e sigurisë. Kërkesat e tilla i shqyrton Komisioni për vlerësimin e kërcënimit (KVK).

3.4. KVK-ja e vlerëson shkallën e kërcënimit të parashtruesit të kërkesës dhe nivelin e sigurisë, nëse ekziston, që kërkohet nga personi në përputhje me kërcënimin e bërë kundër tij apo saj dhe i rekomandon komisarit të Policisë së UNMIK-ut për marrjen e vendimit. LA-ja i lëshohet personit, i cili është vlerësuar si person i rrezikuar ose truprojeve për mbrojtjen e personit të rrezikuar sipas autorizimit të komisarit të Policisë së UNMIK-ut, bazuar në rekomandimin e KVK-së.

3.5. Kërkesa për LA për një apo më shumë truproje për një person të rrezikuar mund të shqyrtohet vetëm pas vlerësimit pozitiv të KVK-së për rrezikshmërinë dhe nivelin e mbrojtjes që kërkohet për personin kryesor përkatës të bërë nga KVK-ja.

3.6. LA-të lëshohen për pistoleta brezi, kurse në rrethanat të jashtëzakonshme LA-të mund të lëshohen për armë automatike me tytë të shkurtër nëse, në raste të veçanta KVK-ja vlerëson se ekziston nevoja për armë të tilla. LA-ja përmban përshkrimin e plotë të armës, duke përfshirë emrin e prodhuesit, modelin, numrin serial dhe informatat tjera identifikuese.

3.7. Municioni që përdorët për një armë të përshkruar nga KVK-ja mund të autorizohet vetëm nga Policia e UNMIK-ut. Municioni i tillë duhet të jetë standard, me mbështjellje të plotë, municion i tipit ushtarak në formë topthi i cili nuk mund të ndryshojë në asnjë mënyrë nga forma e tij origjinale e fabrikës. Kurrfarë municioni tjetër nuk mund të lejohet, duke përfshirë fishekët gjysmë të mbështjellur, shyt, bosh apo të tjerë.

3.8. Policia e UNMIK-ut e bën testimin e armës së lejuar. Fishekët dhe gëzhojat e zbrazta i ruajnë organet kompetente për ruajtjen e rendit dhe identifikohen me armën për qëllim të ndonjë testimi të mëvonshëm ballistik, kriminalistik apo të mjekësisë ligjore.

3.9. Komisari i Policisë së UNMIK-ut mund të përcaktojë pagesat e nevojshme për lëshimin e LA-ve, duke përfshirë edhe pagesat e testimit të armëve dhe të trajnimit të sigurisë.

Neni 4

VERIFIKIMET

4.1. LA-ja nuk mund t'i lëshohet asnjë personi, i cili sipas mendimit të Komisionerit të UNMIK-ut konsiderohet i papërshtatshëm për bartjen e armës.

4.2. Çdo kërkues i LA-së dhe çdo truproje që duhet ta marrë LA-në i nënshtrohet hetimeve dhe hetimet lidhur me përshtatshmërinë e tij a saj për bartjen e armës i bën Policia e UNMIK-ut dhe KFOR-i. Verifikimi paraprak i parashtruesit të kërkesës përfshinë ndër të tjera hetimet lidhur me:

- (a) Dosjen penale, duke përfshirë çfarëdo hetimi penal, padi apo dënim;

(b) Gjendjen gjyqësore ose historikun e sjelljeve të tij violente (duke përfshirë edhe sjelljen shtëpiake);

(c) Shënimet për problemet e shëndetit mental që kanë ndikim në përshtatshmërinë e personit për bartjen e armës;

(ç) Raportet policore të thirrjeve që kanë të bëjnë me shqetësimet e shkaktuara nga kandidati, ose ankesat tjera përkatëse të sjelljeve të padisiplinuara të tij dhe

(d) Të dhënat e organeve vendore lidhur me historikun e konfrontimeve të kandidatit me policinë.

Neni 5

REFUZIMI, PEZULLIMI APO ANULIMI I LA-së

5.1. Komisari i Policisë së UNMIK-ut, me vendimin e tij lirisht mund t'ia refuzojë kandidatit lëshimin e LA-së. Kurrfarë arsyetimi për refuzim nuk ka nevojë t'i jepet kandidatit.

5.2. LA-ja mbetet pronësi e Policisë së UNMIK-ut dhe mund të pezullohet apo të anulohet në çdo kohë nëse komisar i Policisë së UNMIK-ut merr ndonjë informatë e cila sipas mendimit të tij ndikon në përshtatshmërinë e bartësit të armës apo për ndonjë arsye tjetër.

Neni 6

VLEFSHMËRIA E LA-së

6.1. LA-ja vlen, nëse nuk anulohet, për një periudhë jo më shumë se një vit, ashtu siç është përcaktuar në LA, e nëse kohëzgjatja nuk është caktuar, atëherë LA-ja vlen një vit nga data e lëshimit të saj. Bartësi i LA-së mund të paraqitet për marrjen e LA-së së re në muajin e fundit para skadimit të datës së lejes së mëhershme.

6.2. Personi që posedon armën e autorizuar duhet ta ketë me vete LA-në gjatë tërë kohës së bartjes së armës dhe duhet ta tregojë menjëherë atë kur kërkohet nga punonjësit përgjegjës të rendit. Nëse personi nuk është në gjendje apo nuk dëshiron ta tregojë LA-në menjëherë pas kërkesës, atëherë arma i merret në përputhje me nenin e mëposhtëm 7.

6.3. Personi që mban një LA valide duhet ta njoftojë Zyrën Qendrore të Policisë së UNMIK-ut menjëherë pas ndonjë ndryshimi të pronësisë, posedimit apo kontrollit të armës së autorizuar, pas së cilës kohë LA-ja i anulohet.

6.4. Nëse ndonjë person, që mban LA valide, dëshiron t'ia bartë pronësinë, posedimin apo kontrollin e armës së tij apo të saj një personi tjetër, ai apo ajo duhet së pari të marrë leje me shkrim nga Komisar i Policisë së UNMIK-ut. Në mungesë të një autorizimi të tillë, bartja konsiderohet joligjore dhe personi që ia ka dhënë armën si dhe marrësi i armës sipas nenit 8 të mëposhtëm i nënshtrohet ndjekjes penale.

6.5. Personi i rrezikuar, të cilit i është caktuar truproja me LA të vlefshme menjëherë duhet ta informojë Policinë e UNMIK-ut kur truprojës i pushon statusi i tillë. LA-ja nuk është e

pavlefshme pas pushimit të statusit të trupprojës dhe personi i tillë duhet menjëherë t'ia dorëzojë Policisë së UNMIK-ut LA-në e tij.

Neni 7

MARRJA E ARMËVE DHE E LA-ve

7.1. Autoritetet kompetente të ruajtjes së rendit mund të marrin çdo armë apo LA në rastet vijuese:

- (a) Kur LA-ja është pezulluar apo është anuluar;
- (b) Kurë personi që posedon një armë, të cilën ai apo ajo nuk mundet apo nuk dëshiron ta tregojë LA-në menjëherë kur kërkohet nga ndonjë personi kompetent i rendit publik;
- (c) Kur personi e përdor armën në mënyrë kërcënuese, frikësuese ose në mënyrë të paautorizuar;
- (ç) Kur ekziston dyshim i arsyeshëm, i bazuar në informatat e njohura për organet e mbrojtjes së rendit se personi ka kryer apo është duke kryer një kundërvajtje në kundërshtim me këtë rregullore ose në kundërshtim me ndonjë ligj tjetër penal në fuqi dhe
- (d) Atëherë kurë komisar i Policisë së UNMIK-ut vendos se arma e autorizuar i nevojitet mjekësisë ligjore, kriminalistikës apo ballistikës për testim.

7.2. Kur personi që posedon armën e tregon menjëherë LA-në e vlefshme me kërkesë të personit përgjegjës për ruajtjen e rendit dhe kur personi posedon gjithashtu një apo më shumë armë të tjera për të cilat ai apo ajo nuk ka LA të vlefshme, atëherë të gjitha armët i merren nga organet përgjegjëse për ruajtjen e rendit së bashku me LA-në(të), e cila (të cilat) i anulohet(n) menjëherë.

7.3. Në rastet kur autoritetet përgjegjëse të rendit publik e konsiderojnë të domosdoshme për ndonjërin nga arsyet e lartpërmendura apo për arsye të tjera që t'i merret arma personit për të cilën ka LA-në e vlefshme që e tregon menjëherë kur kërkohet, LA-ja i merret dhe i automatikisht i anulohet.

Neni 8

VEPRAT PENALE DHE DËNIMET

8.1. Ky nen vlen për armët e autorizuar nga policia e UNMIK-ut dhe për armët e autorizuar nga KFOR-i.

8.2. Zotërimi, kontrollimi, posedimi apo përdorimi i armës nga cilido person që nuk ka LA të vlefshme paraqet vepër penale.

8.3 Përdorimi apo vringëllimi i çfarëdo arme nga cilido person në mënyrë kërcënuese, frikësuese apo në ndonjë mënyrë tjetër të paautorizuar si dhe atëherë kur ai e porosët bashkëfajtorin të bëjë një gjë të tillë paraqet vepër penale.

8.4 Çdo person i pajisur me LA bën vepër penale nëse nuk e njofton Policinë e UNMIK-ut për çdo ndërrim të pronësisë, posedimit apo kontrollit të armës së autorizuar.

8.5 Çdo person që kryen vepër penale sipas nenit të mësipërm 8.3 i nënshtrohet dënimit me burg deri në 10 vjet ose me të holla deri në 20.000 DM apo që të dyjat së bashku. Personit të tillë i anulohet automatikisht çdo lloj LA-je e lëshuar.

8.6 Çdo person që kryen vepër penale sipas neneve të mësipërme 8.2 dhe 8.4 i nënshtrohet dënimit me burg deri në kohëzgjatje jo më shumë se 8 vjet ose me të holla deri në 15.000 DM ose të dyjat së bashku. Çdo lloj leje që i është lëshuar atij personi automatikisht i anulohet.

8.7 Çdo person që jep informata të rrejshme gojarisht apo me shkrim në cilëndo fazë të procedurës së kërkimit të LA-së bën vepër penale .

8.8 Vepër penale paraqet për çdo person edhe prodhimi, posedimi, shitja apo blerja e LA-së falso.

8.9 Çdo person që kryen vepër penale sipas neneve të mësipërme 8.7 dhe 8.8 i nënshtrohet dënimit me burg në kohëzgjatje jo më shumë se 3 vjet apo me të holla deri në 10.000 DM ose të dyjat së bashku. Personit të tillë automatikisht i anulohet LA-ja e lëshuar.

8.10 Vepër penale bën çdo person i cili ka LA dhe dështon t'ua tregojë menjëherë armën organeve përgjegjëse të rendit kur këtë e kërkojnë, ose kur arma nuk është në posedim të tij a të saj apo kur nuk i informon organet përgjegjëse të rendit për vendndodhjen e armës.

8.11 Vepër penale është edhe atëherë kur personi që mban LA nuk e informon Policinë e UNMIK-ut për çdo ndryshim të adresës së banimit, për të cilën gjë është i obliguar ta njoftojë Policinë e UNMIK-ut brenda afatit prej 15 ditëve pas ndërrimit të adresës.

8.12 Çdo person që kryen këtë vepër penale sipas neneve të mësipërme 8.10 dhe 8.11 i nënshtrohet dënimit me burg në jo më shumë se 3 muaj ose me të holla deri në 5000 DM, apo të dyjat së bashku. Personit të tillë i anulohet automatikisht LA-ja e lëshuar.

8.13 Komisari i Policisë së UNMIK-ut mund të konfiskojë pa kompenzim çdo armë të paautorizuar ose çdo armë të autorizuar që nuk përdoret ose që nuk mbahet në përputhje me rregullat dhe kushtet e LA-së. Armët e tilla të konfiskuara mund të shkatërrohen apo të përdoren për qëllimet e policisë së UNMIK-ut.

Neni 9

ZBATIMI

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të nxjerrë urdhëresa administrative për zbatimin e kësaj rregulloreje.

Neni 10

FUSHËVEPRIMI

Kjo rregullore nuk vlenë për:

- (a) Armët që i përdor KFOR-i, për zyrtarët e autorizuar të Kombeve të Bashkuara, për Shërbimin Policor të Kosovës, për Shërbimin Korrektues të Kosovës apo për personat juridikë të cilët ofrojnë shërbime ndërkombëtare të sigurisë, që janë të regjistruar e të licencuar sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/33 dhe
- (b) Armët e autorizuar të KFOR-it, përveç rasteve të parapara sipas neneve të mësipërme 7 dhe 8.

Neni 11

ARMËT E GJUETISË DHE TË REKREACIONIT

Dispozitat për posedimin e armëve të gjuetisë dhe të rekreacionit, të përmenduar në tabelën A të bashkëngjitur me këtë rregullore do të përcaktohen me një urdhëresë të veçantë administrative.

Neni 12

LIGJI NË FUQI

Kjo rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të.

Neni 13

HYRJA NË FUQI

Kjo rregullore hyn në fuqi më 4 qershor 2001.

Hans Haekerup,
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

SHTOJCA A

Kategoritë e armëve

Kategorizimi: Armët janë kategorizuar dhe përkufizuar si vijon:

1. Pushkë automatike. Armë zjarri automatike që ka mundësi të shkrep zjarr të pandërprerë për aq kohë sa ka municion në të dhe këmbëza është e tërhequr. Kjo përfshinë gjithashtu çfarëdo armë selektive e cila mund të përdoret si armë për të shtëna të veçanta dhe automatike.
2. Pushkë gjysmautomatike. Çfarëdo pushke vetëmbushëse e cila nuk ka mundësi të shkrepë në mënyrë automatike.
3. Pushkë me shul. Çfarëdo pushke që mbështetet në përdorimin me dorë të një mekanizmi me shul për ta mbushur me municion.
4. Revole automatike. Një revole që ka mundësi të shkrepë në mënyrë automatike për aq kohë sa ka municion në të dhe këmbëza është e tërhequr.
5. Revole gjysmautomatike. Çfarëdo revole vetëmbushëse e cila nuk ka mundësi të shkrepë në mënyrë automatike.
6. Revolver. Një revole në të cilën një cilindër rrotullues që ka gojëza të njëpasnjëshme në pjesën e pasme të tytës për zbrazje.
7. Mitraloz i lehtë. Një armë zjarri automatike që ka mundësi të shkrepë zjarr të pandërprerë për aq kohë sa ka municion në të dhe këmbëza është e tërhequr, me një kalibër më të vogël se 12,7 mm, zakonisht i monmtuar në automjet ose në trekëmbësh.
8. Mitraloz i rëndë. Një armë zjarri automatike që ka mundësi të shkrep zjarr të pandërprerë për aq kohë sa ka municion në të dhe këmbëza është e tërhequr, me një kalibër pre 12,7 apo më të madh, zakonisht i monmtuar në automjet ose në trekëmbësh.
9. Armë e diaktivizuar. Një armë që është bërë e paafte për veprim.
10. Mortajat. Të gjithë topat që mbushën kah gryka, të afta për të shkaktuar një zbrazje të lartë shpërthimi.
11. Top anti-tank. Një top, roli primar i të cilit është gjuajta e automjeteve të koracuara (të blinduara) me zjarr direkt.
 - a. ATGW. Armë e dirigjuar antitank. Predhë e dirigjuar drejt objektivit të saj që ka për qëllim t'i godasë automjetet e blinduara.
 - b. LAW. Armë e lehtë kundër automjeteve të karocuara. Çfarëdo armë e lehtë raketore e padirigjuar që zbrazet nga supet dhe që ka për qëllim goditjen e objektivave të karocuar.
 - c. TOW. Armë që lansohet nga një lansues, e përcjellë në mënyrë optike qëllimin dhe dirigjohet drejt tij me anë të një teli dhe

- c. Top antitank. Një top, roli primar i të cilit është goditja e mjeteve të karocuara me zjarr direkt. Arma mund të përdoret gjithashtu edhe për qëllim të zjarrit indirekt.

12. Armë kundërajrore. Armë, roli i së cilës është goditja e objektivave ajrorë. Versionet e ndryshme të këtyre topave mund të përdoren edhe kundër objektivave tokësorë.

13. Granatë (bombë dore) thërmuese. Granatë që hidhet me dorë dhe e cila prodhon copëza të rënda vdekjepruese në një rreze më të madhe se që mund të hidhet ajo.

14. Bombë paralizuese. Granatë dore që shkakton një plasje tejet të zëshme dhe shkrepim të ndritshme që ka për qëllim të çorientojë dhe të demoralizojë pa shkaktuar lëndime.

15. Minë kundërnjerëzore. Minë që ka për qëllim të vrasë, të plagosë ose t'i pafësojë njerëzit.

16. Minë antitank. Një minë që ka për qëllim bllokimin apo shkatërrimin e tankut.

17. Eksplodivat. Një mbushje shpërthuese e cila me rastin e shpërthimit shkakton zjarr, tym, ndriçim ose efekte të tjera.

a. Eksplodiv i lartë (ang. HE). Një substancë kimike e cila kur të ndizet pëson një çrregullim molekular të përcjellur me lirim të nxehtësisë dhe gasit.

b. Formula kërkimore X e departamentit (RDX). Emërtim britanik për eksplodivin të si heksogen apo ciklonit (ang. Hexogen or Cyclonite). Janë shumë të ndjeshëm për t'u përdorur vetëm dhe zakonisht denatralizohen duke i përzier me TNT os dyll dhe

c. Trinitrotoluol (TNT). Materie shpërthuese tejet e lartë që përdoret si mbushje për municion të llojeve të ndryshëm.

18. Municion për armë të lehta. Çfarëdo predhe me kalibër deri në 12,7mm.

19. Municion për përkrahjen e armëve. Çfarëdo predhe me kalibër prej 12,7mm e më shumë. Kjo kategori përfshinë gjithashtu granatat që lancohen me raketa dhe raketat apo predhat antitank.

20. Municion i armëve për zjarrit indirekt. Kjo kategori përfshinë municionin artilerik dhe municionin e mortajave të të gjitha kalibrave.

21. Armët e gjuetisë:

a. Pushkët e gjahut. Pushkët e gjahut nuk mund të kenë kalibër më të madh se 12 dhe nuk mund të zënë më shumë se tre plumba. Pushkët e gjahut duhet të mbushën nga pjesa e pasme, dhëmund të jenë me një tytë apo me tyta të dyfishta. Vëhet në veprim duke lëvizur çarkun me dorë, e aftë vetëm për zjarrë gjysmautomatik dhe e pamodifikuar dhe

b. Pushkët. Pushkët civile të gjuetisë me kalibër maksimal deri në 8mm. Pushkët nuk mund të kenë mundësi të shkrepin zjarr të plotë automatik. Mund të vihen në veprim me shul, me tërhejen e një levi ose me tërheqjen me dorë, pa kurrfarë modifikimi sa i përket konfiguracionit origjinal të fabrikës. Kapaciteti i magazinës së pushkës nuk mund të jetë më i madh se katër fishekë. Gjatësia e përgjithshme nuk mund të jetë më e vogël se 90 centimetra ndërsa tyta nuk mund të jetë më e shkurtër se 60 centimetra. Nuk lejohen shurdhuesit, zvogëluarit e dritës apo teleskopet për vëzhgim gjatë natës.

22. Armët rekreative:

- a. Karakteristikat. Armët rekreative duhet të jenë për një qitje të vetme dhe pa kurrfarë pamodifikimesh.
- b. Pushkët. Pushkë civile të kalibrit të vogël me kalibër maksimal deri në 6mm dhe
- c. Pushkët ajrore. Pushkët ajrore dhe pistoletat me kalibër maksimal deri në 6mm.